

URDHËR
Nr. 80, datë 3.8.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS

Në mbështetje të nenit 204, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Dëshira Pasko, për nënshkrimin e shkresës në zbatim të germës “a”, pikës 37, të vendimit nr. 536, datë 25.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, në kuadër të procedurës së filluar për përzgjedhjen e kandidatëve jomagjistratë, sipas urdhrit nr. 74, datë 26.6.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË
Artur Metani